



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 17, datë 28. 03. 2023

“DHËNIEN E PËLQIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË, NDËRMJET BASHKISE SKRAPAR SI QIRADHËNËS DHE SUBJEKTIT “VOLTALIA ALBANIE” ME NUIS M11403024T, SI QIRAMARRËS, NË EKONOMINE PYJORE/KULLOSORE DOBRENJ – GJOGOVICË, NË FUNKSION TË PROJEKTIT EOLIK”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 28. 03. 2022, mori në shqyrtim projekt aktin e hartuar në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 57/2020 “Për Pyjet”, Ligjit Nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin Kullor” i ndryshuar, nenit 801 e në vijim të ligjit Nr.7850, date 29.07.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-ne, nr.559, date 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimit dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/ përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe prodhimet drusore dhe jo drusorë pyjore”, Udhëzimi nr.1, datë 09.06.2016 i Ministrisë së Mjedisit, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, Shkresa (MIE) nr.7754 datë 28. 10. 2021 “Kërkesë për bashkëpunim mbi ankandin për energjinë e erës”, si dhe njoftimit nr.7143, date 26. 09. 2022, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë “Për procedurën e Kualifikimit për përzgjedhjen e projekteve të erës në tokë që do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje nga zhvilluesi” si dhe në relacionin e përgatitur nga administrata e bashkisë

VENDOSI:

1. Dhënie e pëlqimit për lidhjen e kontratës së qirasë, ndërmjet Bashkisë Skrapar si qiradhenës dhe subjektit “VOLTALIA ALBANIE” me NUIS M11403024T si qiramarrës, të sipërfaqes prej 5 ha, në ekonominë pyjore/kullosore Dobrenj - Gjogovicë, në funksion të “Projektit Eolik”.
2. Për lidhjen e kontratës së qirasë dhe përcaktimin e të drejtave të saj , autorizohet Kryetari i Bashkisë Skrapar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Kryetari i Bashkisë Skrapar.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore.

Vendimi u miratua me 11 vota Pro, Kundër – s’ka, Abstenim – s’ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

